

## MESAZHET E DHËNA NGA ANALIZA VJETORE E KLSH -SË

nga Bedri Çoku - Zëdhënës Shtypi<sup>1</sup>,

botuar në gazetë "Koha jonë", më 23 janar 2014.



Në dy vitet e fundit, Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk ka kryer vetëm shumë auditime, sikurse thekson Progres Raporti i BE-së i vitit 2013. Por raportimet e tij njohën ngritje në cilësi. Këtë e ndjen çdo qytetar, kur nga mediet mëson për konkluzionet e auditimeve të KLSH. Nga ana tjetër, kallëzimet penale të institucionit janë dosje më të përgatitura e të bazuara në ligj, marrëdhëniet me Prokurorinë janë më profesionale e konstruktive. Asnjëherë më parë KLSH nuk ka pasur këtë hapje me publikun dhe me shoqërinë civile, sa në vitet 2012-2013. Këto dy vjet, çdo audituesi i është dhënë shansi të paktën

njëherë të shkojë me shërbim jashtë shtetit dhe të shohë si auditojnë kolegët e tij të institucioneve simotra më të zhvilluara. Audituesit tani përdorin më dendur referimet ndaj standardeve ndërkombëtare të fushës, INTOSAI, por jo vetëm nga trajnimet që zhvillohen, rritje të preکشme të cilësisë ka edhe në raportimet për auditimet e përputhshmërisë dhe auditimet financiare.

Puna audituese në KLSH, në dy vitet e fundit, ka rritur ndjeshëm numrin dhe cilësinë e auditimeve. Audituesit janë orientuar kryesisht tek parimet themelore të auditimit, të Deklarata e Limës, Meksikos, tek standardet e përgjithshme dhe standardet e fushës. Në këta dy vjet, KLSH ka bërë rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve më shumë sa ç'është bërë përgjatë një dekade të fundit 2002-2011. Kjo ndodhi dhe nga shtimi i trajnimeve disa herë në vit për çdo auditues. Janë zhvilluar trajnime me ekspertë të huaj, nga programi i BE-së dhe i OECD-së, SIGMA, për auditimet e performancës, të analizës së riskut, të auditimit financiar, të auditimit të përputhshmërisë, të auditimit të prokurimeve publike dhe të auditimit të teknologjisë së informacionit. Ndërsa numri i audituesve të dalë jashtë shtetit, brenda 2 vjetëve është i barabartë me numrin e atyre që kanë dalë

gjatë tetë viteve 2004-2011. Asnjëherë institucioni nuk ka njohur më parë një ritëm dhe numër të tillë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucionet e tjera supreme të auditivit (SAI-t partnere). Në dy vjet, KLSH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me SAI-t e Austrisë, Sllovenisë, Polonisë, Turqisë, Kosovës, Kroacisë, Malit të Zi, Bosnje-Hercegovinës dhe Maqedonisë, disa herë më shumë nga sa janë lidhur gjatë viteve 1992-2011. Për herë të parë këto marrëveshje nuk kanë qëndruar formale, thjesht në letër, por janë shndërruar në vizita pune dhe trajnime me shtetet partnere, ose në pjesëmarrje aktivitetesh shkencore të zhvilluara ndërmjet të dy palëve.

Gjatë vitit 2013, për herë të parë në gazetën e vendit, 42 nga audituesit e KLSH shfaqën me shkrim, në shtypin e përditshëm, analizat e tyre, idetë që kanë hedhur në raportet e auditimit, si dhe mendimet e zgjeruara për reformat kryesore në fusha të ndryshme të aktivitetit publik. Prej dy vjetësh, KLSH boton revistën shkencore katërmujore "Auditimi Publik", me kontribute nga personalitete të auditimit evropian, si ish-Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI dhe ish-President i SAI-t polak, Jacek Jezierski, Prof. Asoc. Dr. Recai Akyel, President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë, Robert Gielisse, Drejtor Drejtorie në DG-Budget, Joop Vrolijk, Këshilltar i Lartë i SIGMA, etj., krahas shkrimeve, esseve dhe studimeve të akademikëve vendas dhe të audituesve të institucionit. Vlen për t'u përmendur se për herë të parë, në nëntor 2013, institucioni i KLSH mori pjesë modestish, me një pavion, në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Tiranë. Ndërsa në dhjetor 2013, realizoi Konferencën e dytë Shkencore të tij, me 27 studime, prezantime dhe kumtesa nga përfaqësues të DG-Budget, Gjykatës Evropiane të Audituesve, SAI-ve partnere dhe SIGMA, si dhe nga akademikë, personalitete vendas të kontabilitetit dhe auditimit, nga shoqëria civile dhe drejtues e auditues të lartë të Institucionit.

KLSH ka publikuar gjithashtu Udhëzuesin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë, që janë udhërrëfyesit e përditshëm në punën e auditimit. Duke vënë në përdorim këto materiale themelore për punën, audituesit e KLSH do të jenë në gjendje që shumë shpejt të rrisin nivelin analitik të raporteve, si dhe të lehtësojnë strukturën e tyre. Në këtë kontekst është i nevojshëm përvetësimi i koncepteve shkencore të përfshira në pesë numrat e revistës shkencore të KLSH "Auditimi Publik", duke i dhënë vlerë të shtuar punës audituese, si dhe njohurive personale dhe shkencore të audituesve. Vetë ata, në analizat e departamenteve që po zhvillohen këto ditë kanë kërkuar që të lehtësohet volumi i raporteve të auditimit, të kryhet unifikimi i rekomandimeve dhe i terminologjisë së përdorur; të

kryhen trajnime praktike që lidhen me kontekstin real të punës së përditshme audituese; si dhe materialet audituese t'i bëjnë sa me atraktive e të kuptueshme për publikun e gjerë. Këto mesazhe thelbësore në analizat vjetore të Institucionit, në rrafsh departamentesh auditimi, janë shprehur shumë qartë nga Kryetari i KLSH Bujar Leskaj dhe audituesit e këtij institucioni.

---

<sup>1</sup> *Shkrime të tjera të botuara nga Bedri ÇOKU për periudhën Janar–Qershor 2014:*

- *KLSH për ndarjen administrative.*  
(Botuar në gazetën “Koha jonë”, më 27 shkurt 2014 dhe gazetën “Ekonomia”, më 28 shkurt 2014.)
- *Sekretet shtetërore nuk mund të mbrohen pa kontroll.*  
(Botuar në gazetën “Koha jonë”, më 03 prill 2014.)
- *Projekt –ligj i ri për KLSH-në, një mundësi për modernizimin e tij.*  
(Botuar në gazetën “Ekonomia”, më 03 prill 2014.)